



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



**Kuvendi i Komunës Klinë**  
**Komiteti për Politik dhe Financa**  
01Nr. 06-6098 /19  
Klinë, më 18.01.2019

## **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e I-re Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 18.01.2019, me fillim nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal

## **RENDI I DITËS**

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit finansiar të Komunës për vitin 2018 (ref .drejtori i FEZH),
4. Shqyrtimi i procesverbalit të takimit me qytetarë të datës 18.12.2018 dhe rekomandimet e nevojshme për Kuvend,
5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë për vitin 2019,
6. Shqyrtimi i propozimit për shpallje të Zonave Kadastrale: Gjurgjevik i Madh, Dresnik, Klinac e dhe një pjesën Zonës Kadastrale Gllarevë, në anën e majtë të magjistralës Pejë-Prishtinë, si Zonë e mbrojtur nga ushtrimi i veprimtarisë afariste gurore me minim, (ref. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillim Rural),
7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politik dhe Financa për muajin dhjetor 2018 dhe janar 2019,

8. Të ndryshme,

**Pjesëmarrës në mbledhje ishin anëtarët e Komitetit:**

- 1.Violeta Zefi-anëtare
- 2.Enver Berisha-anëtar
- 3.Mendehie Duraku-anëtare
- 4.Tunë Dedaj-anëtar
- 5.Blerta Gashi-anëtare
- 6.Xhevxhet Berisha-anëtar

Ndërsa, pjesëmarrës tjerë ishin: OJQ "KOHA", drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Naser Morina, drejtori i Financave, Aziz Desku, drejtori i Administratës, Binak Sylaj, drejtori i Rinisë dhe Kulturës Skender Merturi, OSBE-Driton Marku, drejtori i Urbanizmit, Lorenc Marleku, Kryesuesi i Komunitetit për Komunitete Enver Gashi.

Në mungesë të Kryesuesit (Fadil Gashi) mbledhjen e hapi anëtari më i vjetër i KPF-së Tunë Dedaj, i cili në fjalën hyrëse përshëndeti të gjithë të pranishmit, kërkoi miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me vota unanim.

**1. Arsyetimi i mungesave.**

**Tunë Dedaj-theksoj** se mungon Fadil Gashi, kryesuesi i KPF-së për arsyen se gjendet jashtë vendit, kaloi tek pika e dytë e rendit të ditës.

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

U shqyrtua dhe unanimisht u votua për miratim procesverbal i seancës së kaluar.

**3. Shqyrtimi i Raportit finansiar të Komunës për vitin 2018 (ref. drejtori i FEZH),**

Fjalën ia dha drejtorit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Aziz Desku.

**Aziz Desku**, -përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe theksoi se Buxheti i Komunës së Klinës, regjistruar në sistemin e menaxhimit finansiar të Kosovës, ka qenë 10,105,634.54 €, që krashtasuar me buxhetin e vitit 2017 ka qenë për 9.01% më i madh,sipas burimeve të financimit buxheti 2018 nga granti Qeveritar ka qenë i financuar me 36.38%, nga të hyrat vetanake me 10.17%, nga të hyrat e bartura nga viti paraprak 2.15%, nga donacionet dhe participimet me 1.29%, nga buxheti total prej 10.105.634.54€ buxheti i shpenzuar për periudhën Janar-Dhjetor 2018 ka qenë 9.485.434.12€, ose shprehur në përqindje është shpenzuar 94% e buxhetit, nga granti qeveritarë është shpenzuar 96.62, nga të hyrat vetanake 70.17%, nga te hyrat e bartura nga viti paraprak 95.95%, participimet 87.99%, donacioni Sav the Children 46.77% dhe donacioni nga Qeveria

Zvicerane 100%, nga buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje janë shpenzuar 61.96%, për mallra dhe shërbime 8.82%, për shërbime Komunale 1.57% për subvencione dhe transfere 0.69%, dhe për kapitale 27.06%, buxheti i shpenzuar ne vitin 2018 krahasuar me buxhetin e shpenzuar në vitin 2017 është për 8.49% më i lart, sa i përket kategorisë së të hyrave kemi një rritje të mirë krahasuar me vitin 2017 dhe nëse e bëjmë një krahasim të të hyrave të vitit 2018 duke përfshirë participimet dhe donacionet janë inkasuar të hyra vetanake në total 1.140.944.26€, dhe në vitin 2018 kjo vlerë ka qenë 901.102.95€, që është për 26.62% më shum se të hyrat e inkasuar për vitin 2017 përkatësisht janë 239,841 € me shumë, të hyrat pa participime, dhe pa donacione për vitin 2018, kapin shifrën prej 1.011.520.40€ në vitin 2017 kanë qenë 809.376.92€, ose në rritje prej 25% krahasuar me vitin paraprak ose shprehur në vlerë absolute për 203.149.48 €, ndërsa sa i përket shpenzimeve kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë disa kategori që kanë pasur rritje dhe disa tjera që kanë pasur zbritje.

Shërbimet që kanë pasur rritje në krahasim me vitin e kaluar janë: shërbimet kontraktuese që në vitin 2018 kapin shumën prej 199.675.28€, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 126.166.77€ shpenzimet për mobilie më pak se 1000€ në vitin 2018 kapin shifrën 24.977€, tek telefonat kemi një rritje me vitin e kaluar, të kompjuterëve, tek kategoria e ushqimit dhe pijev, po ashtu kemi rritje tek kompjuterët, tek furnizimet mjekësoren, ndërsa zgoglim në krahasim me vitin 2017 kemi tek shpenzimet e telefonisë mobile në vitin 2018 janë 12,750€, ndërsa në vitin 2017 kanë qenë 18.774€, furnizime për pastrim në vitin 2018 kanë qenë 9117€, ndërsa në vitin 2017 kanë qenë 15.526€, shpenzime në veshmbathje në vitin 2018 kanë qenë 8506€, ndërsa në vitin 2017 kanë qenë 10.494€. Ka zbritje po ashtu për naftë për ngrohje qendrore: në vitin 2018 ka qenë 27.996€, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 34.540€, tek thëngjilli kemi zbritje për shkak të ndalesës, tek karburantet kemi zbritje për vitin 2018 ka qenë 48.255€, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 64.438€, tek regjistrimet e automjeteve kemi zbritje në vitin 2018 ka qenë 2987€, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 4225€. Edhe tek sigurimi i automjeteve po ashtu kemi zbritje, kemi zbritje edhe tek drekat zyrtare në vitin 2018 kanë qenë 9509.33€, ndërsa në vitin 2017 kanë qenë 11144.60€, dhe po ashtu edhe tek shërbimet komunale kanë zbritje.

**Enver Berisha**-theksoj se ne si shefa të grupeve duhet bërë analizë këtij raporti, ku ky rapport përmua është shqetësues në dy segmente: tek shpenzimet e mjeteve për telefona, mobilie dhe kompjuterë. Dhe e dyta, është ikja e mjeteve nga buxheti i Komunës, projektet ka qenë dashtë te realizohen me kohë dhe të mos lejohet ikja e mjeteve, por do ta japim qëndrimin tonë në mbledhjen e radhës në asamble.

**Violeta Zefi**-falënderoj drejtorin, kam një shqetësim tek Drejtoria e Shëndetësisë për çështjen e participimit kjo shumë nuk e arsyeton numrin e vizitave që janë bërë në Qendrën e Mjekësisë Familjare, edhe pse ka disa kategori që janë të liruara nga pagesa, sa i përket shpenzimeve mendoj se është shpenzuar shumë për anëtarësimin në oden e mjekëve dhe infermierëve.

**Aziz Desku**-një sqarim për çështjet që shtroj Enveri. Jam munduar të bëj një sqarim pa ngjyrime politike, mendoj se për shpenzimet tek kompjuterët dhe mobiliet janë staf i ri dhe ka pasur mungesë të kompjuterëve, po ashtu për shpenzimet e mobilieve ka pasur nevojë edhe tek zyra e Kryetarit. S i përket mjeteve 106 mijë euro, nuk kemi pasur mundësi t'i shpenzojmë apo t'ua transferojmë kompanive pa e kryer punën me kohë, për këtë arsyen kanë sjellë në këtë situatë që këto mjete të shkojnë në suficit.

**Enver Berisha**-tha se nuk pajtohem se nuk ka ngjyrime politike, për kompjuterët është dashur që të kërkohen ku kanë mbetur ata të përparshmit, ndërsa për kompanitë që nuk i kanë kryer punët është dashur të tregohen me ezmer dhe me mbiemër, por mbetet të shihet në të ardhmen.

**Lorenc Marleku**-tha se në fillim të vitit nuk ka pasur asnjë kompani betonim, për dy muaj rresht nuk ka pasur as në rajon. Theksoj se në vitin 2017 ka pasur 14 km rrugë të shtruara në asfalt, ndërsa në vitin 2018 ka pasur 50 km rrugë të shtruara me asfalt, disa kompani kanë marrë vërejtje edhe me shkrim për mos kryerjen e punëve me kohë, shpesh na ka ndihmuar edhe Kryetari deri në ora 21:00 dhe se nuk ka pasur neglizhim në asnjë rast.

**Xhevxhet Berisha**-tha se në seancën e parë kam thënë të mos merrem me shpenzimet e pushtetit të kaluar. Për mua është shqetësuese tek mallrat dhe mobilet. Sa i përket mobilieve ka qenë dashur të përdorën të njëjtat, tek shpenzimet Komunale janë 51.000.00 më pak të shpenzuara nga këto të mbetura a ka ndonjë borxh apo janë më pak të shpenzuara.

**Aziz Desku**-tha se për ma detalisht do të bëj një pasqyrë për mbledhjen e ardhshme, obligime tjera të bartura nuk do të ketë për vitin 2019. Drejtorët e kanë bërë kërkesë për kompjuterë për punëtorët e rinj dhe i kemi pajisur, për telefona është bërë kërkesë nga mbledhja e drejtorëve.

**Binak Syla**-faleminderit Kryesues, pajtohem më Drejtorin për Financa, por disa prej kompjuterëve kanë qenë të vjetër mbi 12 vite dhe eksperti i ITI-së ka deklaruar se nuk funksionojnë ashtu siç duhet për shkak të vjetësisë,

Tunë Dedaj, rekomandoj që të diskutohet edhe në Kuvend, unanimisht ishin pro.

#### **4. Shqyrtimi i procesverbalit të takimit me qytetarë të datës 18.12.2018 dhe rekomandimet e nevojshme për Kuvend.**

U votua dhe u rekomandua që procesverbalit takim me qytetarë i datës 18.12.2018 të shqyrtohet në Kuvend

#### **5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë për vitin 2019.**

**Vlora Tafili**-theksoj se këtë Plan të veprimit e ka hartuar kolegja Samie Gjergji e cila gjendet jashtë vendit.

-Bazuar në nenet 12.1 dhe 12.2të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe në zbatim të udhëzimit administrativ Nr05/2013 për Transparencë në komuna dhe legjislacionin tjetër ne fuqi, po paraqes para jush Draft-Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës Janar-Dhjetor 2019. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky plan i veprimit , Zyra për informim ka hartuar këtë plan në mënyrë që ne si institucion të kontribuojmë në bashkëpunim sa më të mirë në mes administratorëve të komunës dhe qytetarëve.

Ky plan i veprimit ka disa objektiva për përbushje të transparencës në Komunën tonë karshi qytetarëve:

1. Njoftimi për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve përmes webfaqes dhe aktiviteteve tjera të Kuvendit,
2. Konsultimet me Publikun, ku parashihet konsultim për buxhetin, strategjitet e zhvillimit lokal, planifikim hapësinor etj.
3. Mbajtja e takimeve më publikun për çështje të interesit të përgjithshëm,
4. Mbajtja e takimeve dhe intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ e gazetarë,
5. Edrejta e qasjes në dokumente publike,
6. Publikimi i akteve Komunale, përfshirë të gjitha rregulloret, vendimeve dhe dokumenteve të tjera të Kuvendit të Komunës,
7. Freskimi i webfaqes, e cila duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi administrativ ne.01/2015,
8. Prokurimi transparent ,
9. Procedurat e punësimit transparent për qytetarë,
10. Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Komunës etj,

Këto janë disa nga pikat e këtij plani i cili përban edhe disa nënpika ku është hartuar edhe me gjerësisht, materialin shpresoj qe e keni marrë më kohë dhe keni arrit ta lexoni këtë planë.

. 6. **Shqyrtimi i propozimit për shpallje të zonave kadastrale: Gjurgjevik i Madh, Dresnik, Klinafe dhe një pjesë Zonës kadastrale Gllarevë, në anën e majtë të magjistralës Pejë-Prishtinë, si “Zonë e mbrojtur nga ushtrimi i veprimtarisë asariste gurore me minim”(ref.Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillim Rural).**

Naser Morina-përshtëndeti të gjithë të pranishmit, propozoj nga KPF që të ta dërgojë në Kuvend kërkësen përmes së cilës do ia ndalonte organit kompetent të Komunës së Klinës të jep pëlqime te reja operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtarinë afariste gurore me minim (minerare) në këto Zona Kadastrale apo në sipërfaqen që shtrihet në anën e majtë të rrugës Pejë-Prishtinë, prej Dollcit deri në vijën kufizuese administrative më Komunën e Malishevës, Drenasit, dhe

pjesën tjetër që fillon prej Klinafcit e që shtrihet në anën e djathtë të rrugës Klinë-Skenderaj deri te kufiri administrativ me Komunën e Skenderajt.

**Enver Berisha**-pyet Naser Morinën, se a preken kompanitë të cilat janë në veprim apo ata të cilat punojnë me gurë?

**Naser Morina**-theksoj se nuk preken nga ky vendim, sepse ato kanë leje për 5 vite dhe ky vendim vlen vetëm për ata të cilët kërkojnë leje te reja, gjithashtu kjo vlen për ata me minim(minerare) jo për ata qe punojnë me gurë.

**Enver Gashi**-përshtendetje për të gjithë! Kam një pyetje për drejtorin Naser Morinën, a keni paraparë diçka per zonën e cila i përket Xeherores, sepse ajo shkakton edhe pluhur?

**Naser Morina**-me këtë nuk mund të merremi ne dhe se duhet t'i drejtohesh Ministrisë së Ambientit.

**Xhevxhet Berisha**-pyet: kush e jep lejen?Dhe kërkoj qe mos te preken nga ky vendim ata të cilët punojnë me gurë.

**Naser Morina**-theksoj se kjo vlen vetëm për ata të cilët merren me minim, lejet do t'i jep organi kompetent i Komunës,dhe se kjo është në interes të përgjithshëm dhe kërkoj të kaloj për Asamblenë Komunale.

**U votua në mënyrë unanime dhe kaloj në asamble.**

**7.Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politik dhe Financa për muajin dhjetor 2018 dhe janar 2019.**

**Tunë Dedaj**-theksoj se ka një kërkesë nga Tush Dedaj,anëtar i Kuvendit, i cili kërkon nga Kuvendi që për një ndihmë pas intervenimeve kirurgjikale, kontrollimeve mjekësore, e analizave dhe procedurave të tjera, deri tek hemoterapia e tanishme, pas ndihmave të familjes dhe farefisit, detyrohem që t'u drejtohem edhe juve të nderuar,për një ndihmë në përballimin e shpenzimeve të shumta.

**Të gjithë u pajtuan dhe votuan se kjo terkes të kalojë në asamble.**

**8.Të ndryshme:**

**Skender Merturi**- paraqiti një kërkesë për Komitetin për Politik dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës.

Kërkoj nga Kryesuesi i KPF-së dhe i Kuvendit të Komunës ,z.Fadil Gashi,që për seancën e radhës të KPF-së e cila do të mbahet me datë:18.01.2019, të na mundësojë shtimin e një pike të rendit të ditës: Për shqyrtim të propozimit marrjen e Vendimit në Kuvendin e Komunës për formimin e Komisionit për shpalljen e Sportistit të vitit 2018.

Në bazë të Rregullores për përbajtjen e simboleve, Komunale, si dhe për procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjoyeve dhe shpërblimeve tjera,neni 8.8.5 dhe 8.6 dhe Neni 14, 14.1, 14.2 dhe 14.3, parashihet të formohet një komision AD HOC

**Xhevxhet Berisha**-kërkoi nga drejtori i Kulturës Rinis dhe Sportit, që ta përgatis një Raport rreth shpenzimeve të klubeve dhe OJQ-ve për vitin 2018 se si i kanë shpenzuar mjetet,nëse mund ta sjell në seancën e janarit apo të shkurtit, njëkohësisht nëse mund të na sjell edhe një plan se si i parashohin subvencionet për klubet dhe OJQ-të gjatë vitit 2019.

**Enver Berisha**-theksoj se e përkrahi kërkesën për ato llogari për shpenzime të klubeve, realisht është kërkuar edhe më herët, por nuk i kemi marrë ende, është mirë që t'i kemi në seancën e janarit ose të shkurtit.


**Skender Merturi**-do të përpinqem që t'i sjell në seancën e radhës së Kuvendit.

**Tunë Dedaj**-falënderoi të gjithë për pjesëmarrje, me kaq përfundoi mbledhja.

Seanca përfundoj në orën 11:17.

Procesmbajtësi,

Ahmet Berisha



Kryesuesi,

Tunë Dedaj



Anëtar i Vjetor

